



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 03.11.2022

Nr: 27

V E N D I M  
P Ë R

**MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR NUMËRTIMIN E ZONAVE TË QENDRAVE TË  
VOTIMIT DHE QENDRAVE TË VOTIMIT**

Në mbështetje të neneve 20, pika 1, shkronja “a”, dhe 62, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S:

1. Zonat e qendrave të votimit në territorin e Republikës së Shqipërisë numërtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të papërsëritshme nëpërmjet Sistemit Unik të Numërtimit (SUN).
2. Brenda një zone të qendrës së votimit mund të ketë një ose më shumë qendra votimi.
3. Qendra e votimit numërtohet me numër gjashtëshifror, me rend rritës në drejtimin veri - jug. Katër numrat e parë i korrespondojnë zonës së qendrës së votimit dhe dy numrat që pasojnë në rend rritës nga “01” deri “99”, tregojnë qendrat e votimit të krijuara brenda së njëjtës zonë. Ndërmjet katër numrave të parë dhe dy numrave të fundit vendoset karakteri ndarës “/”. Në zonat e qendrave të votimit ku ka vetëm një qendër votimi, numri i qendrës së votimit korrespondon me numrin e zonës së qendrës së votimit dhe pas karakterit ndarës “/” vendoset “00”.
4. Numërtimi fillon me numrin “0001/00” nga Qarku Shkodër e përfundon në qarkun Vlorë.
5. Në rastin e bashkimit të dy apo më shumë qendrave të votimit, numri i qendrës së votimit të shkrirë pezullohet dhe ky pezullim nuk ndikon në numërtimin ekzistues të qendrave të tjera të votimit.
6. Në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ruhet numërtimi ekzistues i qendrave të votimit. Në rastin e qendrave të votimit numërtimi aktual i të cilave është katërshifror shtohet



karakteri ndarës “/” dhe numrat “00”. Në rast se numërtimi aktual i qendrës së votimit është pesëshifror, atëherë përpara numrit të fundit shtohet karakteri ndarës “/” dhe pas tij shtohet “0”. Në rast se numërtimi aktual i qendrës së votimit është gjashtëshifror, atëherë pas katër shifrave të para vendoset karakteri ndarës “/”.

7. Udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2009, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për numërtimin e zonave të qendrave të votimit në mënyrë unike në shkallë vendi” shfuqizohet.
8. Ngarkohen organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe çdo organ që do preket nga miratimi i këtij vendimi, për zbatimin e tij.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO**                      **Kryetar**

**Arens ÇELA**                        **Anëtar**

**Dritan ÇAKA**                       **Anëtar**

**Helga VUKAJ**                       **Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ**                **Anëtar**

